



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 82 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dispozitave të Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, neneve 53 dhe 55.1 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 90 paragrafët 2 dhe 3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, *duke vepruar sipas Shkresës nr.020-338/3 datë 07.07.2025 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal*, Kuvendi i Komunës së Podujevës, pas rishqyrtimit të aktit, në mbledhjen e mbajtur më 30 korrik 2025, mori këtë,

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim anulohet *Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0029235/25 i datës 28.05.2025 për ndryshimin-plotësimin, përkatësisht riformulimin e të dhënave në kuadër të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë viti 2025, të miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836/25 të datës 11.12.2024*

Neni 2

Arsyeja e anulimit të vendimit sipas nenit 1, është për shkak se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vlerësuar se akti i Komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, ndër të tjera duke theksuar paragrafët 1 dhe 2 të nenit 13 të Ligjit 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe atë ku përcaktohet se:

“Komuna duhet të publikoj listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës, si dhe listën e veçantë të pronave të planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues deri më 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik lokal të Komunës”.

“Lista e pronave të paluajtshme për dhënie në shfrytëzim duhet të përmbaj këto të dhëna; të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës”.

Si dhe duke theksuar se Kuvendi i Komunës e Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 11.12.2024 me vendim ka miratuar Listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2025, i cili është konfirmuar nga MAPL dhe është publikuar nga Komuna, dhe mbi këtë bazë duke kërkuar nga Komuna që të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditëve të rishqyrtoj dhe harmonizoj aktin në fjalë me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot. *01-016/01-0044944/25*
Podujevë, datë; 30 korrik 2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Mbështetur në nenet 11; 12.2 shkronja d), 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neneve 13 dhe 8 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në pajtim me nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe nenet 14, 15 paragrafi 2.4, si dhe nenet 17 dhe 19 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2025, mori këtë,

VENDIM

Neni 1

1. Me këtë vendim bëhet ndryshim-plotësimi, përkatësisht riformulimi i të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024, dhe atë:

1.1. E dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të Listës, konkretisht të Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, riformulohet si vijon:
Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.

1.2. Pjesët tjera të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025 dhe Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024, mbeten të pandryshuar.

Neni 2

Arsyeja e ndryshim-plotësimit, përkatësisht riformulimit të tekstit të cekur sipas nenit 1 të këtij Vendimi (nga afatshkurtër në afatgjatë), është se Njësia kadastrale nr.P-00202-3 me sipërfaqe 137157 m², vendi i quajtur "Bugurdoll" Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm-Komuna e Podujevës, sipas planifikimeve vite me radhë është proceduar për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik, por që nuk ka pasur të interesuar për marrjen e kësaj prone në shfrytëzim, ndërsa interesimet si shprehje e interesit të vazhdueshme kanë qenë që kjo pronë të merret në shfrytëzim për periudhë afatgjatë, dhe atë duke synuar për investime kapitale shumë të rëndësishme zhvillimore për Komunën, qytetarët dhe interesit të përgjithshëm publik qoftë me mundësitë e gjenerimit të vendeve të punës, krijimi të hyrave vetanake të Komunës si dhe zhvillimit ekonomik lokal. Rrjedhimisht, është mëse i nevojshëm riformulimi sipas nenit 1 të këtij vendimi, në mënyrë që në aspektin procedural dhe ligjor të krijohen mundësitë e procedimit të mëtutjeshëm në funksion të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së cekur.

HYRËSE - ULAZNA - ПРАВОУЛАЗ		
REKURSI I DRYTËSIAE - REKURZ - REKURZ		
KUVENDI I KOMUNËS TË PODUEVËS		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministry of Local Government Administration		
Data Datum Date:	02.06.2025	
Specia organizative	nr. i Lendës	Viteja
-4/-	020-338	

Neni 3

Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë nr.prot.01-463/06-0078836 për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, i miratuar nga Kuvendi i Komunës më 11 dhjetor 2024

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, si dhe Ligjit Nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot. 01-463/06-0029235/25
Podujevë, datë; 28 maj 2025



20	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-0076135/24 të datës: 26.11.2024 Njësia kadastrale P-00202-1 me sipërfaqe 44773m², Kullosë me klasë 4 në vendin e quajtur "Bugurdull" Zona Kadastrale Lupç i poshtëm	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periodha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënie në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Prill-Qershor 2025	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Bujqësore
21	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-0076135/24 të datës: 26.11.2024 Njësia kadastrale P-00202-2 me sipërfaqe 1908 m², Tokë jo pjellore në vendin e quajtur "Bugurdull" Zona Kadastrale Lupç i poshtëm	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periodha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënie në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Prill-Qershor 2025	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Bujqësore
22	Paluajtshmëria e evidentuar në certifikatën pronësore me Nr.Pro: 08-942/06-0076135/24 të datës: 26.11.2024 Njësia kadastrale P-00202-3 me sipërfaqe 137157 m², Kullosë me klasë 4 në vendin e quajtur "Bugurdull" Zona Kadastrale Lupç i poshtëm	Prona e planifikuar për dhënie në shfrytëzim ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës si dhe krijimin e të hyrave Komunale me qëllim interesin e përgjithshëm publik	Periodha e planifikuar për publikim e njoftimit për dhënie në shfrytëzim të kësaj njësie kadastrale është Prill-Qershor 2025	Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër	Zonë Bujqësore